



Republika Kosova-Republika e Kosovës-Republic of Kosovo
Opština štrpce
Komuna e Shtërpçës
Municipality of Strpce

Duke u bazuar në nenet 12, 40, 51 dhe 53 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, nenin 3, 7, 8 dhe 9 të Udhëzimit Administrativ(MPL) Nr. 05/2020 për Procedurën e Themelimit, Përbërjen dhe Kompetencat e Komiteteve të Përhershme dhe Komiteteve tjera në Komunë si dhe në bazë të neneve 34, 40, 42 dhe 48 të Statutit të komunës së Shtërpçës nr. 01/898 të datës 14.07.2010, Kuvendi Komunal Shtërpçë në seancën e mbajtur më 14.12.2021 miratoi këtë:

VENDIM
PER FORMIMIN E KOMITETIT PER KOMUNITETE

Neni 1.

Me këtë vendim formohet Komiteti për Komunitete prej anëtareve nga përbërja e Kuvendit të Komunës dhe perfaqesues të komuniteteve dhe atë në këto përberje:

1. Blerta Hazizi - Perfaqesuese e komunitetit shqiptar.
2. Muhamet Emini Perfaqesues i komunitetit Rom
3. Albina Hazizi-Anetare e kuvendit (Levizja Vetvendosje)
4. Dragomir Stanisavljevic-Anetar i Kuvendit (Lista Srbska)
5. Vesna Samardzic –Anetare e Kuvendit (Lista Srbska)

Neni 2

Komiteti i komuniteteve është përgjegjës për shqyrtimin e përputhshmërisë së autoriteteve komunale me ligjin në zbatim dhe për shqyrtimin e të gjitha politikave komunale, praktikave dhe aktiviteteve për t'u siguruar se të drejtat dhe interesat e komuniteteve respektohen plotësisht.

Komiteti gjithashtu i rekomandon kuvendit të komunës masat që duhet të ndërmiren për të siguruar jetësimin e dispozitave që kanë të bëjnë me nevojën e komuniteteve për t'u avancuar, shprehur, mbrojtur dhe zhvilluar identitetin e tyre etnik, kulturor, fetar dhe gjuhësor, si dhe për të siguruar mbrojtje adekuate të të drejtave të komuniteteve brenda komunës.

Neni 3

Anëtarët e Komitetit për Komunitete nuk kanë të drejtë të jenë edhe anëtarë të komiteteve tjera.

Neni 4

Anëtarët e Komitetit për Komunitete të emëruar me nenin 1 të këtij vendimi, emërohen me mandat të njëjtë si të Kuvendit të Komunës.

Neni 5

Ky Vendim hynë në fuqi pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81 të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale, Nr-03-L- 040 dhe publikimi në web-faqen Zyrtare të Komunës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Predrag Grbic

